



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.08.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.07.2020, pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit Nr. 50, të datës 02.03.2020 lidhur me Projekt-Hartën Zonale të Komunës Nr. 13543, të datës 07.07.2020 të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, të dorëzuar komunës për plotësim me datën 10.07.2020 nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (d), nenin 17, shkronja (b), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, nën paragrafi 1.2, nën paragrafi 1.2.2, nenin 10, nenin 11, nenin 16 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, (Gazeta Zyrtare Nr. 30/2013), Udhëzimi Administrativ Nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (b), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori këtë:

V E N D I M

Për plotësimin e vendimit Nr. 50, të datës 02.03.2020 për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028

Neni 1

Lloji i dokumentit të Planifikimit Hapësinor

Miratohet propozimi për Hartën Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028, me pjesën tekstuale dhe pjesën hartografike.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të Planifikimit Hapësinor

1. Harta Zonale e Komunës është dokument multisektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, për një periudhë kohore së paku tetë (8) vjeçare.
2. Me Hartën Zonale të Komunës caktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale në kontest të ndryshimeve të bëra me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Neni 3
Afati i vlefshmërisë

Harta Zonale e Komunës së Fushë-Kosovës mbulon periudhën 2020-2028

Neni 4
Zbatimi

1. Harta Zonale e Komunës, cakton dhe definon aspektet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale me objektiva të arritjes së kushteve optimale të rregullimit dhe ndërtimit në zonën urbane dhe rurale të Komunës së Fushë-Kosovës dhe fillon së zbatuari pas konfirmimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit.
2. Zbatimi i Hartës Zonale të Komunës pas konfirmimit nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Drejtorive tjera të komunës.

Neni 5
Gjuhë zyrtare

Harta Zonale e Komunës sipas nenit një të këtij vendimi do të jetë në gjuhë zyrtare të komunës dhe së paku tri kopje të shtypura e të vulosura dhe tri kopje digjitale të originalit.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës, me hyrjen në fuqi dhe zbatim të Hartës Zonale të Komunës shfuqizohen dhe pushojnë së zbatuari Plani Zhvillimor Urban dhe Planet Rregulluese Urbane për Fushë-Kosovën.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së PU, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

